



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 89
Prishtinë, më 6 dhjetor 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 6 DHJETOR 2012**

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Xhavit HALITI**.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Hasime Krasniqi, Hashim Deshishku, Glauk Konjufca, Teuta Haxhiu, Suzan Novobërdaliu, Valbona Dibra, Arben Gashi dhe Visar Ymeri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas përfundimit të kësaj pike të rendit të ditës për fjalë u paraqitën: ministri Bedri Hamza, ministri Ramë Buja dhe nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Kymete Bytyçi parashtroi pyetje për ministrin Mahir Yagcilar në lidhje me zbatimin e kriterit të punësimit për personat me aftësi të kufizuar në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ministri Mahir Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetes Kymete Bytyçi.

Deputeti Goran Marinković parashtroi pyetje për ministrin Fehmi Mujota në lidhje me atë se kur do ta zgjidhë Ministria që ai drejton çështjen që toponimet dhe shenjat treguese në trafik, që janë mbuluar me ngjyrë të zezë, të zëvendësohen në tërë territorin e Kosovës, në mënyrë që ti japim një karakter shumë etnik vendit në të cilin jetojmë.

Ministri Fehmi Mujota iu përgjigj pyetjes së deputetit Goran Marinković.

Deputeti Goran Marinković parashtroi pyetje për ministrin Nenad Rashiq në lidhje me atë se cilat komuna kanë përfutur projekte dhe sa kanë ndikuar ato në zvogëlimin e papunësisë në nivel të Kosovës, për programin e punëve publike në bashkëpunim me komunat e Kosovës, të realizuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetit Goran Marinković.

Deputetja Vjollca Krasniqi parashtroi pyetje për zv.kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me atë se i kujt është dhe kush është qiradhënës i objektit që gjendet afër “Hotel Grand-it”, tash i shfrytëzuar nga EULEX-i?

Zv.kryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Pyetjes së deputetes Vjollca Krasniqi iu përgjigjen ministrat Mahir Yagcilar dhe Agim Çeku.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtroi pyetje për zv.kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me atë se me kë jeni konsultuar lidhur me Projektligjin për përgjimet, i cili u miratua në mbledhjen e Qeverisë më 3 dhjetor 2012. Pra, cilët aktorë të shoqërisë civile apo cilët ekspertë kanë qenë të përfshirë.

Zv.kryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtroi pyetje për zv.kryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me atë se më 29 nëntor 2012, Qeveria e Kosovës deklaroi: “publikimi i përgjimeve të tilla të fabrikua me qëllim të shantazhimit të personaliteteve institucionale dhe jetës së tyre private, është vepër e kundërligjshme dhe e dënueshme”. Po atë ditë EULEX e konfirmoi se ato janë të vërteta. Cila është përgjigja e Qeverisë, a janë të vërteta ato çfarë thuhet në incizimet që dëgjoi opinioni publik?

Zv.kryeministri Hajredin Kuçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Visar Ymeri parashtroi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me borxhin e qytetarëve ndaj KEK-ut, për të cilin është deklaruar publikisht se do ta mbledhë konzorciumi “Limak&Çalik”, në ç’mënyrë dhe sa është përqindja? Pra, cila është baza ligjore që ju lejon t’ia kaloni konsorciumit përqindjen nga mbledhja e këtij borxhi?

Ministri Besim Beqaj nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Visar Ymeri parashtroi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me zëvendësimin e kodeve telefonike aktuale në Kosovë, në bazë të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi me 6 shtator 2012. A kanë filluar negociatat, nëse po në cilën fazë janë ato, nëse jo, kur planifikoni t’i filloni ato?

Ministri Besim Beqaj nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Albana Fetoshi parashtroi pyetje për zv.kryeministren Mimoza Kusari-Lila në lidhje me dhënien e licencave subjekteve afariste që sipas raportit të auditorit për vitin 2011, nuk ishte në pajtueshmëri të plotë me kornizën ligjore, përfshirë udhëzimin administrativ 07/2010 dhe ligjin nr.03/L-138 për tregti me naftë dhe derivate të saj.

Zv.kryeministria Mimoza Kusari-Lila iu përgjigj pyetjes së deputetes Albana Fetoshi.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë,
5. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për eficiencën e energjisë,
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga tatimi i vlerës së shtuar deri më 31 dhjetor 2014,
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit,
8. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve plenare të mbajtura më 15, 16 dhe 22 nëntor 2012.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë

Kryesuesi Xhavit Haliti e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit, të paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë.

Ministri Bedri Hamza tha se ky projektligj ka për qëllim të ratifikojë marrëveshjen kornizë për bashkëpunim financiar të nënshkruar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Austrisë, më 12 korrik 2012, në kuadër të së cilës do të zbatohen projektet zhvillimore dhe bashkëpunimi financiar ndërmjet dy vendeve, në fushat e përcaktuara me marrëveshje.

Në vazhdim ai tha se mbi bazën e marrëveshjes kornizë të ratifikuar nëpërmjet këtij ligji do të nënshkruhen marrëveshjet për projektet e veçanta në fushat e përcaktuara në aneksin 2 të marrëveshjes dhe në kushtet e parapara në aneksin 1 të marrëveshjes.

Pastaj, ministri Hamza u fokusua në aspekte tjera të projektligjit, ndërsa në fund i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadergjona-në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa si dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albana Fetoshi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje,” Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, ndërsa Duda Balje, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëpunim financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë.

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 93 deputetë.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 87,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet ligji nr. 04/L-166 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë.

5. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për eficiencën e energjisë

Deputeti Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, tha se si komision kemi monitoruar mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për eficiencën e energjisë dhe Kuvendit ia kemi paraqitur Raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim.

Më tej ai u fokusua në elaborimin e tërësishëm të këtij raporti dhe rekomandimeve që ka paraqitur Komisioni Funkcional.

Në fund, ai kërkoi miratimin e këtij raporti.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për eficiencën e energjisë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Myzejene Selmani, në emër të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për eficiencën e energjisë.

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 73 deputetë.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 70,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Raporti me rekomandime i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 04/L-016 për eficiencën e energjisë.

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga tatimi i vlerës së shtuar deri më 31 dhjetor 2014

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës për paraqitjen dhe arsyetimin e këtij Propozim-vendimi.

Ministri Bedri Hamza tha se Propozim-vendimi për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga tatimi i vlerës së shtuar deri më 31 dhjetor 2014, është i bazuar në ligjin nr.03/L-146 për tatimin mbi vlerën e shtuar që sipas Ligjit, kanë filluar me 1 janar 2012 dhe përfundojnë me 31 dhjetor 2012, në atë mënyrë që të zgjatet periudha kalimtare duke filluar nga 1 janar 2013 deri më 31 dhjetor 2014.

Më tej ministri tha se zgjatja e kësaj periudhe kalimtare nënkupton edhe vazhdimin e periudhës tranzitore për mosimplementimin e dispozitave të caktuara në fushat specifike siç referohen në paragrafin 3 të nenit 64, domethënë për aktivitetet pa të drejtë të zbritjes së TVSH-së së zbritshme siç është referuar në nenin 27 të Kreut VIII të Ligjit mbi TVSH-në.

Në fund ministri Hamza i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga tatimi i vlerës së shtuar deri më 31 dhjetor 2014.

Deputetja Safete Hadergjonaj, në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, tha se si komision kemi shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga Tatimi i vlerës së shtuar deri më 31 dhjetor 2014 dhe Kuvendit i kemi paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare.

Ajo në fund përkrahu Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga tatimi i vlerës së shtuar deri më 31 dhjetor 2014.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hykmete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albana Fetoshi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Duda Balje, në emër të Grupit Parlamentar "6+", si dhe Armend Zemaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga tatimi i vlerës së shtuar deri më 31 dhjetor 2014.

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 65 deputetë.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 58,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e periudhës kalimtare të lirimeve nga tatimi i vlerës së shtuar deri më 31 dhjetor 2014.

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Deputeti **Zenun Pajaziti**, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, tha se si komision e kemi shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe kemi vendosur që me shumicë votash t'i rekomandojmë Kuvendit miratimin në mbledhje plenare.

Ai më tej tha se në komision është debatuar dhe është arritur si të thuash të votohet me një kusht, që CV-it e disa prej anëtarëve të plotësohen me informatat shtesë të cilat u mungojnë. Meqë kjo nuk ka ndodhur, mendoj që grupet parlamentare duhet të vendosin vetë se çka do të bëjnë.

Ai, gjithashtu, shprehu edhe qëndrimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, duke theksuar se pasi që nuk janë plotësuar këto CV, meqë në ndërkohë nuk kanë arritur informatat shtesë për këta kandidatë, kjo pikë e rendit të ditës të mos aprovohet sot dhe të kërkohet nga Qeveria që sa më shpejtë të plotësohen emrat ose CV-it e tyre me informatat shtesë të cilat duhet t'i kenë të gjithë deputetët në Kuvendin e Kosovës.

Ismet Beqiri tha se Grupi Parlamentar i LDK-së mendon se ajo që kërkon tash Grupi Parlamentar i PDK-së është dashur me herët të plotësohet e jo të vijë në seancë.

Ne nuk e përkrahim, gjegjësisht do të votojmë kundër këtij propozimi për këta kandidatë, anëtarë të bordit, për disa arsye. Pra, arsyeja kryesore është që ky bord është i politizuar. Këtë e kemi thënë shumë qartë edhe në paraqitjet tona dhe po e themi edhe sot.

Arsye tjetër ai përmendi moskompletimin e dosjeve dhe mungesës së përvojës nga ana e disa anëtarëve të propozuar.

Visar Ymeri tha se Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosjes” konsideron që kjo listë e paraqitur me kandidatë për anëtarë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit është e papranueshme, për shumë arsye që u thanë këtu, por edhe për disa arsye tjera. Pra, është listë me eksponentë të partisë në pushtet, pra të Partisë Demokratike të Kosovës, me përjashtim të zotit Haxhi Arifi, i cili është kryetar i Sindikatës dhe rrjedhimisht këtë post në Bordin e AKP-së e ka sipas detyrës zyrtare.

Ardian Gjini tha se ka qenë dashur që kryetari i Komisionit ose përfaqësuesi i Qeverisë në fillim të seancës të na tregoj se nuk janë plotësuar kushtet sipas Komisionit që Kuvendi të votojë sot për këtë listë.

Mendoj se praktikisht do të ishte jo në rregull që ne të votojmë, qoftë për , qoftë kundër emrave të njerëzve për të cilët nuk kemi marrë as biografi. Pra, mendoj se kjo duhet të kompletohet dhe të bëhet në seancën e parë të radhës sa më shpejt të jetë e mundshme, theksoi ai.

Myzejene Selmani tha se duke marrë parasysh arsyet që i paraqiti kryetari i Komisionit Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për çështjen e biografive të anëtarëve të bordit, kjo çështje është tashmë e vonuar dhe është dashur që ato t’i sjellin përpara se të dalin emrat e tyre në seancë.

Biserka Kostiq tha se Grupi Parlamentar SLS e mbështet propozimin që kjo çështje të shqyrtohet në njërën nga mbledhjet plenare të radhës.

Adem Grabovci kërkoi që të hidhet në votim mocioni i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës.

Diskutimet e deputetëve për këtë pikë të rendit të ditës janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim mocionin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për njërën nga mbledhjet e ardhshme.

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë të pranishëm 65 deputetë.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 46,
Kundër----- 34,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

1. Zgjedhja e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit shtyhet për njërën nga mbledhjet e ardhshme të Kuvendit.
2. Kërkohet nga Qeveria e Kosovës që sa më shpejtë t’i plotësojë CV-it e kandidatëve të propozuar me informatat shtesë dhe ato t’ia dërgojë Kuvendi të Kosovës.

8. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i LDK-së ka propozuar deputetin Imri Ahmeti, anëtar në Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në vend të deputetit Armend Zemaj.

Ai kërkoi nga deputetët që, nëpërmjet një votimi, me ngritje dore të deklarohen për propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Deputeti Imri Ahmeti emërohet anëtar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në vend të deputetit Armend Zemaj.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur mbledhjen plenare në orën 12:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale